



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



## **Tregu i Bizneseve**

### **QËLLIMI**

Tregu i Bizneseve ka për synim mbështetjen e bizneseve të vogla, bizneseve me ide kreative dhe OJQ-ve. Qëllimi i këtij tregu është krijimi i hapësirave dhe mundësive për bizneset dhe OJQ-të në Kryeqytet, me theks të veçantë atyre që veprimtarinë kryesore e kanë punën e dorës.

Përfituesi i kësaj shtëpize do të ketë rastin të bëjë shitjen e veshjeve tradicionale, suvenireve, aksesoreve, dhuratave, kartolinave punëdore, luleve etj.në shtëpizën në sheshin “Edit Durham”.

### **RREGULLAT E TREGUT TË BIZNSEVE**

#### **1) Vendi dhe orari i punës**

Shtëpiza për të cilën publikohet Thirrja gjindet në sheshin “Edit Durham”.

Orari i punës do të jetë çdo ditë, nga e hëna në të dielën duke filluar prej orës 09:00 deri në orën 22:00. Asnjë shitje nuk do të lejohet para orës 09:00 si dhe pas orës 22:00.

## 2) Kriteret e aplikimit

Përzgjedhja e aplikuesit do të bëhet nga një komision i posaçëm i formuar nga Kryeqyteti.

Kriteret të cilat duhet t'i plotësojnë aplikuesit janë këto:

- Aplikimi do të bëhet për shitjen e veshjeve tradicionale, suvenireve, aksesoreve, dhuratave dhe kartolinave punëdore, luleve etj.;
- Aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës si dhe të jenë pajisur me arkë fiskale;
- Aplikuesit duhet të kenë dëshmi të ushtrimit të veprimtarisë specifike për të cilën do të aplikojnë;
- Aplikuesit duhet të jenë të pajisur me mjete/vegla të përshtatshme pune për veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë në Tregun e Bizneseve;
- Bizneset/OJQ-të të cilat udhëhiqen nga grate, do të trajtohen me prioritet;
- Bizneset/OJQ-të të cilat janë të regjistruara në Komunën e Prishtinës, do të trajtohen me prioritet;
- Bizneset/OJQ-të të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore do të trajtohen me prioritet;

Pasi që bëhet fjalë vetëm për një shtëpizë e cila është e lirë dhe mund të jepet në shfrytëzim përveç këtyre kriterëve të cekura me lartë, kriter themelor është kriteri kohë.

Aplikuesi/ja i cili i dorëzon dokumentacionin e aplikimit i/e para nga data e njoftimit dhe i plotëson kriteret e cekura si më lartë do përzgjedhet si përfitues i marrjes në shfrytëzim të kësaj shtëpize.

### **3) Tarifa e shfrytëzimit të shtëpizës**

Tarifa për shfrytëzimin e shtëpizës të tregut të bizneseve është e përcaktuar duke u bazuar në rregullorën për shfrytëzimin e hapësirave publike, ku pagesa aplikohet në bazë të hapësirës publike të cilën e zë një shtëpizë. Pra, përfituesi do të jetë i obliguar të paguajë paraprakisht shumën prej **10.00 Euro për m2** për periudhë një mujore të shfrytëzimit të shtëpizës në hapësirë publike.

### **4) Kodi i mirësjelljes dhe obligimet shtesë**

Të gjithë shfrytëzuesit e shtëpizave janë të obliguar të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfillt në mes tyre. Në mënyrë që ky bashkëpunim të jetë sa më mire, Komuna e Prishtinës ndalon rreptësisht aktet si më poshtë:

- Kryrjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme brenda hapësirës së tregut;
- Abuzimin verbal ose fizik të personave të cilët përfaqësojnë përfituesit konkurrues, si dhe të blerësve apo qytetarëve të tjerë kalimtar;
- Shitjen e produkteve të cilat nuk janë paraparë të shiten në asnjërën prej shtëpizave;

- Obligohen të gjithë përfituesit që pas përfundimit të orarit të punës ta pastrojnë shtëpizën e tyre dhe hapësirën rreth saj;

Nëse bëhet kryerja e akteve të lartëshënuara, sanksionimi do të jetë marrja e lejës për shtëpizë dhe nuk do të bëhet kthimi i mjeteve të paguara për shfrytëzimin e saj.

**Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet prej 25.10.2023 deri me 8.11.2023 në Qendrën për Shërbim me Qytetar, në Komunën e Prishtinës ( objekti i vjetër).**